

AKTI I THEMELIT TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“ngn” sh.p.k.

Sot më datë 31.05.2024 në Tiranë, une i nënshkruari Endri MEKSI, shtetas shqiptar, lindur më 01.07.1979, në Tiranë dhe banues në Tiranë, mbajtës i kartes se identitetit me nr. personal H90701154E,

në mbështetje të Ligjit nr. 9091 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, të Ligjit Nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” dhe legjislacionit shqiptar të zbatueshëm:

Vendosa:

të nënshkruaj Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar (këtu e më poshtë referuar Shoqëria), aktiviteti i të cilës rregullohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi dhe Statutit të saj i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi, të cilit i bashkëngjitet (më poshtë Shtojca 1).

Neni 1

Emërtimi i Shoqërisë

1.1 Shoqëria është krijuar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Emërtimi i shoqërisë është “ngn” sh.p.k (këtu e në vijim e referuar Shoqëria).

Neni 2

Selia

2.1 Selia e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “ngn” shpk eshte ne adresën Njesia Administrative Farke, Rruga Lunder, Kodra e Derhemeve, Nd. nr 2, Farkë, Tiranë, Shqipëri.

Neni 3

Objekti i Aktivitetit

3.1 Objekti i Aktivitetit së Shoqërisë do të jetë kryerja e shërbimeve informatike, tregtimin e tyre, shitblerjen e cdo lloj produkti teknologjik per shoqërinë e informacionit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3.2 Objekti i Shoqërisë do të përfshijë dhënien e shërbimeve këshilluese dhe shërbimeve të tjera ndihmëse për aktivitetin kryesor sipas parashikimeve të ligjit.

3.3 Shoqëria mund të ushtrojë gjithashtu aktivitete të tjera financiare jo-bankare në përputhje me të drejtat e dhëna nga autoritetet përgjegjëse të caktuara me ligj.

Neni 4

Kohëzgjatja e Shoqërisë

4.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë të pakufizuar.

Neni 5

Kapitali i Shoqërisë

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë “ngn” shpk është 1,000,000 Lekë (një milion Lekë) dhe përfaqëson 100% te kapitalit , ku:

Ortaku themelues eshte z.Endri Meksi, i cili zotëron 1 kuote me vlerë te përgjithshme 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

5.2 Kapitali është nënshkruar dhe shlyer tërësisht nga ortaku i vetëm, Z. Endri Meksi.

5.3 Kuotat e Ortakut/ve regjistrohen ne librin e regjistrimit te kapitalit te shoqërisë.

5.4 Pjesët e kapitalit janë të transferueshme dhe mund të transferohen në çdo moment sipas kushteve dhe afateve të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

Neni 6

Ortaku i Vetëm

6.1 Ortaku i Vetëm është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë.

6.2 Ortaku i Vetëm është z. Endri Mexsi, i biri i Aleksandrit, i datëlindjes 01.07.1979 lindur dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartes se identiteti me nr. personal H90701154E.

Neni 7

Administratori i Shoqërisë

7.1 Administrimi i Shoqërisë do të kryhet nga Administratori.

7.2 Administratori emërohet me Vendim të Ortakut të Vetëm dhe qëndron në këtë detyrë për një afat jo më të gjatë se 5 vjet. Administratori mund të rizgjidhet për të njëjtën periudhë me vendim të Ortakut të Vetëm.

7.3 Administrator i Shoqërisë do të jetë Z. Endri Mexsi.

Neni 8

Viti Financiar

8.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 9

Audituesi Ligjor

9.1 Auditimi i brendshëm i Shoqërisë kryhet nga një ose shumë ekspertë kontabel të regjistruar të emëruar me vendim të Ortakut të Vetëm për çdo vit financiar në përputhje me kriteret dhe rregullat e përcaktuara nga kuadri ligjor e rregullator në fuqi.

Neni 10

Prishja dhe Likuidimi

10.1 Ortaku i Vetëm mund të vendosë për prishjen e Shoqërisë. Prishja e Shoqërisë do të shoqërohet me likuidimin e saj.

10.2 Shoqëria vazhdon të ekzistojë si person juridik vetëm për nevoja të likuidimit deri në përfundim të këtij procesi dhe gjatë likuidimit, togfjalëshi “në likuidim e sipër” duhet të vihet pas emrit të shoqërisë.

Neni 11

Gjuha

11.1 Ky Akt Themelimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “ngn” sh.p.k është përpiluar në katër kopje në gjuhën shqipe me vlerë të barabartë.

Tiranë, më 31.05.2024

ORTAKUI VETËM

ENDRI MEKSI

